
Në Qendrën multimediale “Stacioni i vogël” sot (18 dhjetor) me fillim në ora 18:30, do të hapet ekspozita e pavarur e pllakateve autoriale të prof. m-r Ladisllav Cvetkovski, që është pjesë e projektit të tij artistik „Komentet e mia“ nga cikli “Të zezat”...



Ekspozita është prerje e 70 pllakateve nga cikli „Të zezat“ që, për herë të parë, do të prezantohen në formë të shtypur në Maqedoni. Edhe pse pllakatet komentojnë ngjarje, deklarata, sjellje të personave, mentalitete dhe gjendje konkrete, me to Ladisllav Cvetkovski dëshiron të japë porosi universale dhe të rikujtojë për disa vlera të humbura. Ky prezantim është pjesë e programit nacional të Ministrisë së Kulturës dhe për publikun do të jetë në dispozicion deri më 28 dhjetor.